

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT, PROGRAMET DHE FINANCIMIN E SHËRBIMIT TË SPECIALIZUAR PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti synon të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të specializuara për të miturit në konflikt me ligjin për të cilët është caktuar një masë sigurimi për vendosjen në shërbim të specializuar, programet përkatëse dhe financimi i këtyre shërbimeve të specializuara.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon në nenin 84 se kur interesat e të miturve kërkojnë një vëmendje të posaçme dhe që për rrethana konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërt atëherë i mituri vendoset në një shërbim të specializuar. Shërbimi i specializuar mundësohet nga institucionet publike ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Mbështetja dhe rehabilitimi i të miturve që në fazën e hetimeve paraprake apo gjatë gjykimit, nëpërmjet kësaj mase sigurimi është një element që i shërben rishoqërizimit të të miturit dhe largimit të tij nga ambientet kriminale. Për shkak të moshës delikate dhe faktorëve social, kur mbikëqyrja nuk mund të ofrohet nga familja dhe të afërmit, mbikëqyrja dhe mbështetja nga profesionistë të fushave të specializimit ka një rëndësi themelore për krijimin e mjedisit miqësor dhe trajtimin e të miturit.

~~Mbështetja e të miturit nëpërmjet shërbimit të specializuar ofrohet në bashkëpunim me të miturin, prindërit e tij, kujdestarin, institucionet e mirëqenies sociale, arsimit, mjekë dhe profesionistë të tjerë, ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm mbi personalitetin dhe sjelljen e të miturit dhe kujdesen për trajtimin e tij sipas një plani individual të mbikëqyrjes.~~

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023.

Projektvendimi është hartuar në përmbushje të delegimit ligjor të bërë në nenin 84, pika 3 e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektakti miraton rregulla të detajuara mbi mënyrën se si duhet të organizohen, funksionojnë, programet dhe mënyrën e financimit të personave juridikë apo institucion që ofrojnë shërbime të specializuara për të miturin ndaj të cilit është caktuar një masë e tillë sigurimi, sipas nenit 82 dhe nenit 84 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Projektvendimi materializon qasjen e reformës në fushën e drejtësisë penale për të mitur për të realizuar një mundësi trajtimi të të miturve pranë institucioneve apo personave juridikë të licencuar për t'u ofruar atyre shërbime të specializuara sipas nevojave për zhvillim dhe riintegrim kur gjykata e vlerëson të arsyeshme dhe të përshtatshme vendosjen e një mase të tillë sigurimi.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon se ndaj të miturit nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë, nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me një masë më të lehtë. Kur kërkohet të caktohet masë sigurimi ndaj një mituri, prokurori në kërkesë dhe gjykata në vendim mban parasysht dhe arsyeton interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të një të mituri.

Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa: a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje; b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.

Vendosja e të miturit në shërbim të specializuar bëhet kur mbikëqyrja e tij nuk mund të bëhet pranë familjes dhe kur nuk garantohet dot paraqitjes së të miturit, sa herë kërkohet, përpara oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës.

Në rastet kur gjykata vlerëson vendosjen e kësaj mase sigurimi, duhet të përcaktojë edhe institucionin përkatës (shërbimin e specializuar) pranë të cilit

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin"

do të vendoset i mituri. Kur shërbimi i specializuar nuk mund të ofrohet nga institucionet publike, gjykata mund të caktojë një nga organet e licencuara për ofrimin e këtij shërbimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektvendimi. Ndaj edhe nisma e propozuar, paraqitet si një iniciativë e ministrit të Drejtësisë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 84, pika 3 të ligjit 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS TË BE-SË* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përcakton rregullat lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e institucionit ose personit juridik të licencuar për zbatimin e masës së sigurimit të vendosjes në shërbim të specializuar për të miturin në konflikt me ligjin.

Projektvendimi është i ndarë në gjashtë krerë dhe i përbërë nga 22 nene.

Kreu I përcakton objektin e këtij projektvendimi lidhur me miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin, programet dhe financimin e institucioneve ose personave juridikë të licecnuar për ofrimin e shërbimeve të specializuara për të miturit ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “vendosje në shërbim të specializuar”.

Kreu II përcakton rregullat e organizimit të shërbimeve të specializuara. Në rregullat kryesore të organizimit parashikohet se ofruesi i shërbimit duhet të këtë një strukturë të përshtatshme të personelit në përputhje me nevojat e përfituesit të mitur.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

Gjithashtu, për subjektet e licencuara parashikohet se zbatohet legjislacioni në fuqi për lejet dhe licencat si dhe legjislacioni në fuqi për prokurimin publik në rastet kur vetë institucionet publike të vetëqeverisjes vendore nuk kanë kapacitete për ofrimin e këtij shërbimi.

Në nenin 3 të këtij projektvendimi parashikohet se lista e institucioneve, qoftë atyre publike, qoftë e subjekteve të licesuara duhet ti vendoset në dispozicion gjykatave me qëllim që gjykatat të kenë dijeni për mundësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve sipas rretheve gjyqësore, në mënyrë që të zbatohet kjo masë sigurimi.

Në këtë kre parashikohen edhe rregulla mbi detyrat e personelit për zbatimin e shërbimit të specializuar për të miturit që janë nën masën e sigurimit si dhe dokumentacioni që mbahet për personelin që ofron shërbimin, me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimit nga personel i specializuar për të garantuar interesin më të lartë për të miturin. Në këtë kre projektvendimi parashikon se ofruesi harton rregullore të brendshme në të cilën detajohet përshkrimi i detyrave të çdo punonjësi si dhe trajnimi i tyre.

Kreu III parashikon rregullat mbi funksionimin e shërbimeve të specializuara. Projektvendimi thekson se qëndrimi në shërbimin e specializuar për të miturit në konflikt me ligjin nuk është vullnetar pasi kjo është një masë sigurimi e detyrueshme dhe i mituri mund të largohet vetëm në raste kur gjykata vendos revokimin e masës së sigurimit ose zëvendësimin e saj. Nëse i mituri largohet pa njoftuar nga shërbimi duhet të informohen menjëherë strukturat e policisë, prokuroria kompetente dhe gjykata që ka dhënë vendimin për vendosjen e të miturit në shërbimin e specializuar.

Ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin hartojnë dokumentacion të qartë të të drejtave të përfituesit të shërbimit të specializuar. Këto të drejta duhet të jenë të shkruara në gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Të drejtat duhet të përfshijnë minimalisht të drejtën për t'u trajtuar në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, me respekt dhe dinjtet, të drejtën për t'u dëgjuar dhe shprehur mendimet, të drejtën për t'u ankuar pa pasur frikën e pasojave negative.

Nevojat e të miturit në konflikt me ligjin që vendoset në shërbimin e specializuar vlerësohen nga një ekip multidisiplinar, të cilët punojnë së bashku për të trajtuar rastin në përputhje me moshën dhe nevojat, me qëllim hartimin e planit individual të mbikëqyrjes.

Për çdo përfitues të mitur caktohet një punonjës social, i cili menaxhon rastin. Menaxheri i rastit udhëheq procesin e vlerësimit të nevojave të përfituesit, hartimin e planit të mbikëqyrjes dhe zbatimin e tij. Ai takohet rregullisht me përfituesin e mitur për të diskutuar progresin e përgjithshëm në arritjen e qëllimeve individuale dhe planit të mbikëqyrjes. Ai ndihmon përfituesin e mitur duke hartuar planin e mbikëqyrjes. Plani i mbikëqyrjes hartohet pas vlerësimit të nevojave dhe përfshin masat afatmesme dhe afatgjata të nevojave të identifikuara për përfituesin e mitur në konflikt me ligjin.

Lidhur me programet, në projektvendim parashikohet se shërbimet e specializuara ofrojnë trajtim, përkujdesje, udhëzime, këshillime, mbikëqyrje, mbështetje dhe rehabilitim për të miturin që dyshohet se ka kryer një vepër penale dhe ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit.

Bazuar në nevojat e evidentuara, programet për të miturin përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- a) ofrimin e aktiviteteve edukative, sportive, rekreative dhe kulturore;
- b) ofrimin e kujdesit psikologjik dhe psikosocial;
- c) ofrimin e përkujdesjes shëndetësore bazë dhe, kur është rasti, referimin e të miturit në institucionet përgjegjëse për kujdesin shëndetësor;
- ç) ofrimin e kujdesit shëndetësor të posaçëm në rastet e varësisë ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike e psikotrope;
- d) ofrimin e kujdesit të shëndetit mendor për të miturit që shfaqin çrregullime mendore;
- dh) ofrimin e shërbimeve mbështetëse për të miturit e huaj apo pa shtetësi, si dhe të miturit që i përkasin pakicave kombëtare;
- e) ofrimin e kujdesit shëndetësor të posaçëm për të miturit me aftësi të kufizuara;
- ë) ofrimin e këshillimit dhe lehtësimin e ndjekjes së arsimit dhe arsimit profesional dhe punësimin;
- g) ofrimin e aktiviteteve këshilluese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit për respektimin e ligjit dhe të drejtave të të tjerëve.

Projektvendimi parashikon se ofruesit e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin bëjnë çdo përpjekje për të bashkëpunuar me strukturat dhe shërbimet e tjera, duke siguruar ndjekjen e ecurisë dhe plotësimin e nevojave të përfituesit dhe shoqërizimin e tyre.

Me qëllim zbatimin e programeve, hartohet plani individual i mbikëqyrjes i nga punonjësi social, i cili menaxhon rastin bazuar në nevojat e evidentuara për të miturin.

Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin i kërkon përfituesit të mitur, prindërve apo personit të afërt të të miturit të plotësojnë në mënyrë anonime formularin e vlerësimit të shërbimit. Në formular ata vlerësojnë shërbimet e ofruara, në mënyrë që shërbimet të përmirësohen sipas nevojave. Formulari plotësohet çdo tre muaj ose dhe më shpesh, në rastet kur janë ndërmarrë veprime për të trajtuar ankesat, opinionet dhe sugjerimet ndaj shërbimeve të ofruara.

Lidhur me monitorimin e ofrimit të shërbimit, në këtë kre parashikohet se ofruesi i shërbimit të specializuar monitorohet dhe inspektohet në përputhje me legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin raporton, çdo tre muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve pranë prokurorisë dhe gjykatës që ka vendosur masën e sigurimit. Në çdo rast, ofruesi raporton sa herë që i kërkohet nga prokuroria dhe gjykata që ka vendosur masën e sigurimit.

Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe jopublike të licencuara.

Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo gjashtë muaj, të dhëna mbi zbatimin e masave të sigurimit për të miturit, ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit. Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin gjithashtu pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhëna periodike mujore mbi të miturit ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit, llojin e veprës penale për të cilën është vendosur masa e sigurimit dhe kohëzgjatjen e saj.

Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin siguron një procedurë legjitime dhe funksionale për ankimet. Përfituesi, prindërit ose personi i afërt i të miturit mund të ankohet rreth çdo aspekti të jetesës në këtë shërbim, si dhe për shërbimet që ka marrë ose jo.

Në rastet kur ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin nuk është më i aftë të vijojë veprimtarinë, drejtuesi informon menjëherë ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale për të siguruar një ofrim të pandërprerë të shërbimit për të miturin.

1. Kreu IV përcakton rregulla mbi administrimin e të dhënave. Projektvendimi parashikon rregulla në lidhje me administrimin e dosjeve individuale të të miturve si dhe me procedurat e ankimit të tyre. Administrimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të

dhënave personale. Të dhënat e dokumentacionit të të miturit në konflikt me ligjin janë konfidenciale. Personeli i shërbimit të specializuar për të miturit që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Kreu V parashikon rregulla mbi financimin e shërbimeve të specializuara. Ofruesit e shërbimeve të specializuara, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

Programet që ofrohen nga personat juridik publikë që ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin financohen, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror nga;

- a) fondet e deleguara nga buxheti i shtetit, përfshirë fondin social;
- b) fondet nga buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore;
- c) të ardhura të tjera të ligjshme.

Programet që ofrohen nga personat juridik privatë të licencuar që ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin mund të financohen nga fondet e deleguara nga buxheti i shtetit, vetëm nëse kanë lidhur kontratë për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme që i vijnë ofruesit të shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin, përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Kreu VI i projektvendimit parashikon rregulla të fundit mbi miratimin e akteve të tjera nënligjore dhe zbatimin e projektvendimit si dhe hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin"

Projektakti është hartuar nga Ministria Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të UNICEF dhe TLAS “Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë”. Projektakti i është nënshtruar një procesi konsultimi paraprak me institucionet ligjzbatuese dhe shoqërinë civile. Projektakti ka qenë objekt diskutimi i tryezës së rrumbullakët të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF dhe TLAS të organizuar në datën 8 Maj 2018, në Tiranë, me temë “*Për konsultimin e projekteve nënligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur*”.

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, projektvendimi është shpallur në Regjistrin Publik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Nga verifikimi kryer, nuk rezultojnë komente në këtë regjistër për këtë projekt akt.

Projektakti është përcjellë për mendim pranë MSHMS, MFE, MASR, MB, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Agjencisë së Prokurimit Publik. Pas bashkërendimit me këto institucione, projektakti është përcjellë në Këshill të Ministrave për miratim, ku Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave e ka kthyer projektvendimin për ripunim.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar në tërësi projektvendimin duke e paraqitur atë në përmbajtjen e përmbledhur si më sipër.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe vendimit nr. 910, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, projektakti është diskutuar në mbledhjen e Këshillit Konsultativ të datës 24.04.2023.

Projektakti i dërgohet për mendim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencisë së Prokurimit Publik, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokurorisë së Përgjithshme.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet sistemit e-aktet është shprehur se:

1. Pika 3, germa a) e nenit 20 të projektaktit përcakton se: “Programet që ofrohen nga personat juridik publikë që ofrojnë shërbimet e specializuara për të miturit në konflikt me ligjin financohen, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror, nga a) fondet e deleguara nga buxheti i shtetit, përfshirë fondin social...”, çka do të thotë, që

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

projektakti implikon kosto nga buxheti qendror. Ndërkohë, në relacion nuk del e qartë nëse ka fond të dedikuar në buxhetin qendror për këtë qëllim dhe, nëse po, si akordohet ky fond në personat juridikë publikë. Relacioni i referohet vetëm buxhetit të miratuar për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në institucionet e vetëqeverisjes vendore. Në këto kushte, kërkohet nga MFE që relacioni shpjegues të reflektojë edhe këtë përcaktim në pikën e fundit të tij, si dhe të japë të dhëna konkrete lidhur me këtë financim.

➤ Lidhur me komentin e përcjellë, MD sqaron se shërbimet shoqërore të specializuara ofrohen në nivel vendor nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, rrjedhimisht në projektvendim është përcaktuar mënyra e financimit të këtyre institucioneve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimet shoqërore.

2. Projektvendimi ka si bazë ligjore nenin 84, pika 3 të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, në pikën 2 të të cilit përcaktohet se: “Shërbimi i specializuar mundësohet nga institucionet ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përkatësisht ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në të cilin janë përcaktuar shumë struktura qendrore si edhe roli i bashkisë dhe strukturave përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. Duke qenë se projektakti ka të bëjë me shërbime të specializuara dhe, në pikën 1 të nenit 3 të tij thuhet se: “Me qëllim ofrimin e shërbimit të specializuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, çdo 6 muaj përcjellin pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale raportim mbi kapacitetet për ofrimin e shërbimeve të specializuara”, mbetet e paqartë nëse MSHMS ka ndonjë raport që evidenton ekzistencën dhe nivelin e këtyre kapaciteteve në 61 bashkitë e vendit.

➤ MD sqaron se referuar legjislacionit në fuqi për shërbimet shoqërore MSHMS, është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave në ofrimin e shërbimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe shërbimet e specializuara. Gjithashtu, Shërbimi Social Shoqëror, institucion në varësi të MSHMS, është organi përgjegjës për monitorimin e shërbimeve shoqërore, ndaj MSHM mund ta realizojë këtë proces në konsultim edhe me Shërbimin Social Shoqëror. Përpos këtij fakti, MSHMS është organi përgjegjës për licencimin e personave juridikë në fushën e ofrimit të shërbimeve shoqërore dhe rrjedhimisht vlerësohet se në mbështetje të legjislacionit të fushës, në kuadër të përmbushjes së detyrave ligjore, ka kapacitetet e nevojshme për të vlerësuar nëse institucionet e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojnë shërbime të specializuara ose jo.

Gjithashtu, gjatë procesi të bashkërendimit të projektaktit me MSHMS, kjo ministri nuk është shprehur mbi pamundësinë e vlerësimit të raportimit që do të bëjnë organet e vetëqeverisjes vendore.

3. MFE ka sugjeruar se një raport nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale duhet të jetë pjesë e relacionit të këtij projektakti, për të kuptuar implikimin financiar që mund të sjellë për NJVQV-të ky projektvendim. Në mbështetje të argumenteve të mësipërme citohet edhe ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 22, pika 3 e të cili, përcakton se: “Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare”.

Bashkëpunimi mes pushtetit qendror dhe atij vendor është një nga parimet e mirëqeverisjes por, në raport me këtë projektvendim, vlerësohet se ky bashkëpunim mund të sjellë kosto shtesë në buxhetin qendror. Argument mbi implikimet e mundshme në buxhet është edhe prokurimi i shërbimeve të tilla nga vetë NJVQV-të, të cilat nuk i ofrojnë shërbime të tilla dhe, për të cilat, relacioni nuk shpjegon nëse ato i kanë të parashikuara ose jo fonde të tilla.

➤ MD thekson se e ka përcjellë projektaktin pranë MSHMS për mendim, ku ndër të tjera kërkohet edhe dhënia e mendimit lidhur me implikimet financiare. Nisur nga fakti se MSHMS është institucioni përgjegjës për planifikimin buxhetor për ofrimin e shërbimeve shoqërore, duhet që çdo vit buxhetor të planifikojë edhe buxhetin e nevojshëm për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, sipas nevojave. Lidhur me krijimin e kostove shtesë në buxhetin e shtetit, vlerësohet se ofrimi i shërbimeve të specializuara është detyrë e njësive të vetëqeverisjes vendore sipas legjislacionit aktual në fuqi. Rrjedhimisht, nuk rrjedhin kosto buxhetore shtesë pasi ky është një shërbim që duhet të ofrohet tashmë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Ndërkohë, lidhur me numrin e të miturve që mund të ofrohet ky shërbim, është e pamundur të përlllogaritet pasi numri i të miturve që do të vendosen në këtë shërbim varet nga vendimmarrja e gjykatës bazuar në veprat penale të kryera nga të miturit, si dhe nga lloji i veprave penale për të cilat mund të zbatohet kjo masë sigurimi. Duke qenë se kjo masë sigurimi deri më tani nuk është aplikuar për shkak se mungon rregullimi (nëpërmjet këtij akti nënligjor) nuk ka as statistika për të kryer një vlerësim prima facie mbi numrin e mundshëm të të miturve që do të vendosen në vijim në shërbimet e specializuara.

4. Neni 3, pika 3 e projektvendimit që përcakton se: “Personat juridikë të licencuar për ofrimin e shërbimeve shoqërore të specializuara mund të kontraktohen vetëm nëse kanë të paktën 5 vite përvojë në ofrimin e shërbimeve shoqërore për të miturit”, është i paqartë se mbi çfarë argumenti është zgjedhur ky afat. Vlerësohet se për tu licencuar si subjekte që ofrojnë shërbime të specializuara në kuptim të këtij vendimi, subjektet jopublikë duhet të plotësojnë një sërë kriteresh, çka i bën ata të aftë për të operuar në treg që në momentin e marrjes së licencës, që në këtë rast merret nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Argument mbështetës për komentin e mësipërm është legjislacioni i zbatueshëm në RSH, i cili rregullon fushën e prokurimeve publike. Ky legjislacion, në çdo rast të kontratave për punë publike dhe/ose mallra (ku përfshihen volume jo të vogla dhe financa të konsiderueshme), kërkon nga kompanitë deri në 3 vjet eksperiencë. Bazuar në arsyetimet e mësipërme dhe pasi krijohet ideja e fituesve të paracaktuar jopublikë në ofrimin e shërbimeve që do të prokurohen dhe për të cilat referohet ky projektvendim, në vlerësimin e MFE ky afat duhet të hiqet.

➤ Në kuadër edhe të sugjerimeve të përcjella nga Agjencia e Prokurimit Publik, MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë duke e hequr pikën 3 nga përmbajtja e nenit 3 mbi kriterin për përvojën në ofrimin e shërbimeve shoqërore për të miturit.

5. Në nenin 4/2 dhe 9/c duhet të bëhet referim i kujdesshëm lidhur me punonjësit e qendrave sociale, fokusi për të cilët janë fushat sociale dhe mjekësore, por nevojat janë po kaq arsimore si paraqitet në këtë projektvendim.

➤ MD vlerëson se komenti i përcjellë është i paqartë pasi në projektvendim nuk konstatohen problematika lidhur me punonjësit e qendrave dhe vlerësimin e nevojave për të miturit.

6. Neni 12, i cili flet për monitorimin e shërbimeve të specializuara që ofrohen për të miturit në konflikt me ligjin, shprehet se: “Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror monitorojnë përmbushjen e kriterëve dhe zbatimin e programeve për zbatimin e masës së sigurimit për të miturit në konflikt me ligjin”, duke e lënë të paqartë se cilat janë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për këtë monitorim dhe nëse këto struktura e kanë fushë të përgjegjësisë së tyre shtetërore monitorimin e këtyre shërbimeve.

➤ Neni 12 i projektvendimit është riformuluar në vijim edhe të bashkërendimit me MSHMS, duke përcaktuar si autoritetin monitorues Shërbimin Social Shoqëror, si autoriteti përgjegjës për monitorimin e ofrimit të shërbimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, është

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

parashikuar se inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe jopublike të licencuara. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe personave juridikë jopublikë, që ofrojnë shërbimin e specializuar. Ofruesi i shërbimit të specializuar monitorohet dhe inspektohet në përputhje me legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror.

7. Neni 12 që përcakton se: “Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin gjithashtu pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhëna periodike mbi të miturit...”, mbetet evaziv lidhur me periodicitetin e raportimit dhe me llojin e të dhënave që shërbimet e specializuara do të raportojnë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

➤ Lidhur me këtë koment, MD vlerëson se periodiciteti i raportimit duhet të jetë mujor, me qëllim gjenerimin e të dhënave në kohë sa më të shpejtë. Rrjedhimisht, është bërë shtesa përkatëse mbi periodicitetin e të dhënave.

8. Në të gjitha rastet kur dispozitat e këtij projektvendimi flasin “për persona juridikë publikë ose jopublikë”, togfjalëshi të zëvendësohet me “subjekte juridikë publikë ose jopublikë”, bazuar në dispozitat e të drejtës tregtare.

➤ MD sjell në vëmendje se termi “persona juridikë” është përdorur në përputhje me paragrafin 2 të nenit 84 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Po kështu, terminologjia është në përputhje me Kreun II të Titullit I, të Pjesës I të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe nuk bie ndesh me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet sistemit e-aktet është shprehur se:

1. Në Kreun II, neni 2, pas pikës 6, sugjerohet shtimi i një pikë shtatë me këtë përmbajtje:

“7. Këto rregulla janë pjesë e protokollit të standardeve të shërbimit, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë”.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë. Ndërsa sugjerimi mbi miratimin e protokollit edhe nga ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë vlerësohet se ministria përgjegjëse për drejtësinë nuk ka ekspertizë për hartimin e standardeve të ofrimit të shërbimit të specializuar, të cilat për nga përmbajtja duhet të jenë rregulla teknike mbi mënyrën e ofrimit të shërbimeve të specializuara.

2. Lidhur me nenin 12, të projektvendimit meqenëse Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është autoriteti monitorues i shërbimeve dhe Shërbimi Social Shtetëror është institucioni, i cili monitoron standardet e shërbimeve dhe jo zbatimin e masës së sigurimit, sugjerohet riformulimi i këtij neni me këtë përmbajtje:

“1. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike dhe jopublike të licencuara. Ofruesi i shërbimit të specializuar monitorohet dhe inspektohet në përputhje me legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror.

2. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve nga ofruesit e shërbimit të specializuar publike, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridikë jopublikë, që ofrojnë shërbimin e specializuar, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.

3. Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin raporton, çdo tre muaj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve pranë prokurorisë dhe gjykatës që ka vendosur masën e sigurimit. Në çdo rast, ofruesi raporton sa herë që i kërkohet nga prokuroria dhe gjykata që ka vendosur masën e sigurimit.

4. Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo gjashtë muaj, të dhëna mbi zbatimin e masave të sigurimit për të miturit, ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit.

5. Ofruesit e shërbimit të specializuar paraqesin gjithashtu pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhëna periodike mbi të miturit ndaj të cilëve është vendosura masa e sigurimit, llojin e veprës penale për të cilën është vendosur masa e sigurimit dhe kohëzgjatjen e saj”.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë.

3. Lidhur me nenin 15, pika 1, paragrafi i parë, sugjerohet heqja e termit ”miraton”. pasi nuk është qendra që miraton procedurat e ankimit, por janë pjesë e standardeve të shërbimit, që miratohen me akt nënligjor. Po në këtë nen, paragrafi i dytë, sugjerohet që të riformulohet si me poshtë vijon:

“Këto procedura, të cilat janë pjesë e standardeve të shërbimit të jenë të hapura për të gjithë përfituesit, mbrojtësit dhe/ose përfaqësuesit ligjor dhe familjarët e tyre”. Në pikën 2, Procedurat e ankimit ndiqen dhe shqyrtohen nga strukturat monitoruese dhe inspektuese, sipas ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore, jo MSHMS. Gjithashtu sugjerohet të hiqet togfjalëshi “ .. si dhe pranë ministrisë përgjegjëse

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

për çështjet sociale”, dhe të zëvendësohet me togfjalëshin “...duke respektuar procedurat e ankimit”.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë në paragrafin 1, 2 dhe 3 të nenit 15 të projektvendimit.

4. Pika 3 sugjerohet të riformulohet, si më poshtë vijon:

“3. Rregullorja e brendshme e qendrës përfshin procedurën e ankimit që përmban kushtet e konfidencialitetit, afatet e përgjigjes dhe organet/personat që trajtojnë ankesën. Të gjitha ankesat e marra me gojë apo shkrim dhe përgjigjet e dhëna hidhen në regjistrin e ankesave, dhe i gjithë dokumentacioni mbahet në një dosje të veçantë”.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë në pikën 4 të nenit 15.

5. Gjithashtu në Kreun VI, sugjerohet që pas nenit 21, të shtohet neni 22, me këtë përmbajtje:

“22. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë, të miratojnë udhëzimin sipas nenit 2, pika 7, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë në nenin 21.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nuk ka përcjellë mendim lidhur me këtë projektakt.

Agjencia e Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës nr. 2899/1 prot., datë 19.04.2023 është shprehur se:

1. Në nenin 3, pika 2, togfjalëshi “në përputhje me kreun 12 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” duhet të zëvendësohet me togfjalëshin “në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik”, me qëllim që ky citim të mos ndikojë në zbatimin e projektvendimit lidhur me ndryshimet që mund të pësojë ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

➤ Ministria e Drejtësisë ka reflektuar komentin e APP.

2. Në nenin 3, pika 3, duhet të hiqet kriteri 5 vjeçar mbi përvojën e subjekteve të licencuara pasi në procedurat për shpalljen e fituesve të kontratave për shërbimet, duhet të bëhen në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorit ekonomik dhe nxitjes së konkurrencës.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

➤ Ministria e Drejtësisë sqaron se ky kriter është vendosur për shkak të natyrës së veçantë që ky shërbim i specializuar ka për mbikëqyrjen e të miturve që kanë kryer një apo disa vepra penale dhe niveli i përvojës duhet të jetë i avancuar në raport me të miturit e tjerë që nuk janë të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë vlerëson se ky kriter mund të shqyrtohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë paraqitjes së ofertës. Në përfundim, Ministria e Drejtësisë ka reflektuar komentin e APP duke e hequr pikën 3 nga përmbajtja e nenit 3.

Këshilli i Lartë Gjyqësor nëpërmjet shkresës nr. 2208/3 prot., datë 24.04.2023 është shprehur dakort me përmbajtjen e projektvendimit duke sugjeruar:

1. Parashikimin e një dispozite mbi parimet mbi të cilat zbatohen shërbimet e specializuara.

➤ MD sjell në vëmendje se parimet mbi ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror parashikohen në nenin 4 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” e rrjedhimisht konsiderohet e panevojshme përsëritja e tyre në këtë akt nënligjor.

2. Parashikimin e procedurës në rastet kur i mituri nuk respekton detyrimet e vendosura ndaj tij.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë nga KLGJ duke shtuar një paragraf në nenin 11 të projektvendimit.

3. Parashikimin e detyrimit të prindrit apo përfaqësuesit ligjor të të miturit gjatë procesit të vendimarrjes, në nenin 8 të projektvendimit. Ky sugjerim vjen për shkak të moshës së të miturit, zhvillimit apo aftësisë për të kuptuar.

➤ MD ka reflektuar sugjerimin e dhënë nga KLGJ duke shtuar një paragraf në nenin 8 të projektvendimit, por duke e kushtëzuar prezencën me interesin më të lartë të të miturit, duke marrë parasysh se në raste të veçanta në praktikë kontakti i të miturit me përfaqësuesit e tij nuk e ndihmon procesin dhe nuk ndikon pozitivisht në mirëqënien psikologjike dhe emocionale të të miturit.

4. Në nenin 10 të projektvendimit të përfshihet si pjesë e programeve të shërbimeve të specializuara edhe ofrimi i këshillimit për nxitjen e punësimit dhe ndjekjen e programeve të formimit profesional.

➤ MD ka përfshirë edhe këshillimin për punësimin në shkronjën “ë” të pikës 2 të nenit 10 të projektvendimit.

5. Në nenin 12 sugjerohet riformulimi i pikës 1 si vijon “*Ofruesi i shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin raport, çdo tre muaj, pranë prokurorisë dhe gjykatës që ka vendosur masën e sigurimit, në lidhje me shërbimin e ofruar.*”.

➤ Ministria e Drejtësisë ka reflektuar sugjerimin e KLGJ.

6. Në nenin 15, lidhur me paraqitjen e ankesave duhet të përcaktohet se ankesat mund të paraqiten me shkrim ose verbalisht dhe të parashikohet detyrimi se në rastet kur ankesa paraqitet verbalisht duhet të mbahet edhe procesverbali përkatës. Gjithashtu sugjerohet parashikimi i një afati 7 ditor për trajtimin e ankesës.

➤ Ministria e Drejtësisë ka reflektuar sugjerimet e KLGJ duke riformuluar pikën 1, 5 dhe 6 si dhe duke shtuar një pikë të re (pika 2 e nenit 15).

7. Në nenin 17 të projektvendimit të parashikohet edhe rasti i ndërprerjes së shërbimit kur kjo kërkohet nga i mituri, prindi apo përfaqësuesi ligjor për të kërkuar zëvendësimin e shërbimit në rastet kur i mituri shpërdoron të drejtat e tij, shkel detyrimet që i janë caktuar ose cënon interesin më të lartë të të miturit.

➤ Lidhur me këtë sugjerim MD sqaron se objekti i këtij projektvendimi është parashikimi i rregullave administrative mbi organizimin e shërbimeve të specializuara dhe programet e tyre. Aspektet procedurale të procesit penal mbi revokimin apo zëvendësimin e masave të sigurimit rregullohen nga Kodi i Procedurës Penale dhe një parashikim i tillë nuk vlerësohet i nevojshëm dhe as i përshtatshëm për tu parashikuar në këtë projektvendim.

Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet shkresës nr. 530/1 prot., 27.04.2023 datë është shprehur se:

1. Në projektvendim është e paqartë se cilët subjekte të licencuar jopublikë do të përfshihen në listat që mund të sidponohen nga gjykata. Në praktikë mund të krijohen problematika lidhur me pagesën dhe shërbimin e kryer.

➤ Ministria e Drejtësisë sqaron se ofruesit e shërbimeve të specializuara janë së pari njësitë e vetëqeverisjes vendore. Vetëm në rastin kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë kapacitetet e nevojshme, mund t’ja delegojnë këtë detyrë subjekteve të licencuara për ofrimin e shërbimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat dhe legjislacionit në fuqi për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Përzgjedhja e subjektit të licencuar nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

Referuar nenit 3 të projektvendimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, kanë detyrimin të përcjellin informacionin pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me aftësinë e tyre për të ofruar shërbimin e specializuar apo kontraktimin e subjektit përkatës të licesnuar. Pas marrjes së informacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e përcjell informacionin pranë të gjitha gjykatave me qëllim pasjen në dispozicion të listës së njërive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekteve të licesnuara që mund të ekzekutojnë masën përkatëse të sigurimit.

Lidhur me komentin se në praktikë mund të krijohen problematika lidhur me pagesën e subjekteve të licencuara, vlerësohet se në zbatimin e procedurave të prokurorit publik, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të respektojnë të gjitha rregullat e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë këtu edhe rregullat e parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në projektvendim të përfshihen edhe kritere mbi kapacitetet e nevojshme infrastrukturore për ofrimin e shërbimeve të specializuara për të miturit në konflikt me ligjin për faktin se ambientet dhe kushtet e përshtatshme për të miturit kanë një rëndësi të posaçme në këtë proces.

➤ Ministria e Drejtësisë sqaron se objekti i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave mbi funksionimin e shërbimit të specializuar, programet përkatëse dhe financimi i tyre. Përcaktimi i kriterëve infrastrukturore përfshihet në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk mund të rregullohet nëpërmjet këtij projektvendimi.

3. Titulli i nenit 5 të ndryshohet si vijon: “Dokumentacioni i personelit të shërbimit të specializuar”

➤ Ministria e Drejtësisë ka reflektuar sugjerimin.

4. Është i nevojshëm rishikimi i përmbajtjes së relacionit shoqëruar me qëllim reflektimin e dispozitave të projektvendimit dhe qartësimin e përmbajtjes së tyre.

➤ Ministria e Drejtësisë sqaron se përmbajtja e relacionit është rishikuar në tërësi pas bashkrëndimit të projektaktit me institucionet e interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”

Në zbatim të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shërbimet e specializuara janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie ndër të tjera, edhe për fëmijët në konflikt me ligjin, siç janë në rastin konkret të miturit ndaj të cilëve është vendosur një masë sigurimi si të mitur në konflikt me ligjin (kur dyshohet se kanë kryer një vepër penale).

Shërbimet shoqërore të specializuara janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror në institucionet e vetëqeverisjes vendore ku strukturat e kujdesit shoqërore janë pjesë e detyrueshme e organikës së këtyre njësive. Rrjedhimisht, duke qenë se çdo njësi e vetëqeverisjes vendore ka tashmë të ngritur strukturat e shërbimeve shoqërore, ofrimi i këtyre shërbimeve nuk krijon kosto shtesë për të miturit ndaj të cilëve është caktuar një masë sigurimi nga gjykata.

Në rastet kur institucionet e vetëqeverisjes vendore nuk e ofrojnë dot shërbimin e specializuar, mund të kontraktojnë subjekte të licencuar për ofrimin e shërbimeve shoqërore, brenda buxhetit të miratuar për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në institucionet e vetëqeverisjes vendore.

Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i institucioneve publike në rastet kur i mituri vendoset në një shërbim të specializuar publik. Këto institucionet janë përgjegjëse për hartimin e kërkesës buxhetore për fondin, që është i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e rasteve të fëmijëve që vendosen në shërbim të specializuar.

Për të llogaritur efektet financiare duhen mbajtur në konsideratë kostot indikative për ofrimin e shërbimit të specializuar në institucionet rezidenciale dhe ditore publike. Mbështetur në PBA 2023-2025 të MSHMS, kosto indikative vjetore për fëmijë të moshës 0-18 vjeç që përfitojnë shërbime në institucionet publike të përkujdesit është 1 339 487 lekë për përfitues¹ Ndërsa kosto indikative për qendrat ditore mund të merret sa gjysma e shpenzimeve për qendrat rezidenciale të fëmijëve ose 669 774 lekë për përfitues.

Nga të dhënat statistikore rezulton se janë regjistruar 572 të mitur si të pandehur, ose persona nën hetim, për kryerjen e veprave penale dhe ndaj 25 prej tyre është vendosur masë sigurimi arrest në burg, e cila përbën rreth 4,3% të të pandehurve të mitur² Mbështetur në këto të dhëna mund të planifikojmë që 60 të

¹ PBA 2023-2025, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Planifikimi për vitin 2024

² Raporti Vjetor kriminaliteti 2022 Kuvendit Prokuroria e Pergjithshme 6915%20.pdf, fq.193

mitur ose 10.5% e totalit për 2022 mund të kenë nevojë për marrjen e shërbimeve të specializuara rezidenciale dhe ose ditore.

Lloji i shërbimit	Numri i përfituesve	Kosto indikative	Totali
Shërbim i specializuar rezidencial	10	1 339 487	13 394 870
Shërbim i specializuar ditor	50	669 774	33 487 200
	60		46 882 070

Efekti total i zbatimit të projekt vendimit është 46 882 070 lekë në vit. Efekti është në nivel kombëtar dhe kërkon hartimin e kërkesës buxhetore nga ofruesit publikë të shërbimeve dhe NJVQV. MSHMS është përgjegjëse për mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e specializuar rezidencial publik në kuadër të programit buxhetor Përkujdesja sociale.

Ndërsa strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për hartimin e kërkesës buxhetore për fondin për shërbimin e specializuar ditor, i cili është i nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në territorin që ato mbulojnë. Fondi për menaxhimin e rasteve të reja që mund të identifikohen duhet të parashikohet në programin “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA

